



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-07

Prokurori kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt

Vendosi: Trupi Gjykses II

Gjykatës Çarls L. Smith, III, kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 7 tetor 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim lidhur me Kërkesat e Mbrojtjes për Rishikimin e Vendimit F00328

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Methju Haling

Valeria Boliçi

Xhejms Paç

Mbrojtësit të Hysni Gucatit

Xhonatan Elistan Ris

Hju Bouden

Mbrojtësit të Nasim Haradinajt

Tobi Kadman

Karl Bakli

TRUPI GJYKUES II ("Trupi Gjykues"), në bazë të nenit 40(2) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullës 79 të Rregullores së Procedurës dhe Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 2 shtator 2021, në konferencën për ecurinë e çështjes gjyqësore, Trupi Gjykues urdhëroi palët të dorëzonin mocione sipas rregullës 117 jo më vonë se 17 shtator 2021.

1

2. Më 17 dhe 18 shtator 2021, Mbrojtja e Hysni Gucatit ("Mbrojtja e Gucatit")² dhe Mbrojtja e Nasim Haradinajt ("Mbrojtja e Haradinajt")³ dorëzuan mocionet ("Mocioni i Gucatit", "Mocioni i Haradinajt" dhe bashkërisht, "Mocionet") ku kundërshtonin pranueshmërinë e deklaratave të dëshmitarëve të ZPS-së, W04841 dhe W04842 ("dëshmitarët").

3. Më 24 shtator 2021, Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") iu përgjigj Mocioneve ("Përgjigjja").⁴

4. Më 27 shtator 2021, Trupi Gjykues lëshoi një urdhër me anë të cilit rrëzonte Mocionet dhe theksonte se Mbrojtja do të kishte mundësi gjatë gjykimit të kundërshtonte pranueshmërinë e deklaratave, si dhe për t'iu drejtuar pyetje dëshmitarëve ("Urdhri").⁵ Pasi mori Mocionin e Haradinajt një ditë pas përfundimit të afatit të caktuar, Trupi Gjykues i tërhoqi vërejtje Mbrojtjes së Haradinajt lidhur me

¹ Urdhri për Caktimin e Afateve për Dorëzimin e Mocioneve sipas Rregullës 117, 2 shtator 2021, f. 603, rreshti 21 deri në f. 604, rreshti 1.

² F00317, Mbrojtja e Gucatit, *Mocion për Kundërshtimin e Pranueshmërisë së Provave sipas Rregullës 138(1) ("Mocioni i Gucatit")*, 17 shtator 2021, konfidencial. *Shih edhe* F00317/RED, publik.

³ F00318, Mbrojtja e Haradinajt, *Kërkesë sipas Rregullës 117(2) për Shpallje si të Papranueshme të Dëshmitarëve të ZPS-së ("Mocioni Haradinajt")*, 18 shtator 2021, konfidencial.

⁴ F00322, Prokurori i Specializuar, *Përgjigje përmbledhëse e Prokurorisë ndaj Kundërshtimeve të Mbrojtjes në lidhje me Pranueshmërinë ("Përgjigjja")*, 24 shtator 2021, konfidencial.

⁵ F00328, Trupi Gjykues, *Urdhër mbi Mocionet e Mbrojtjes sipas Rregullës 117 ("Urdhri")*, 27 shtator 2021, para. 18.

afatet e protokollimit të parashtrimeve, por e pranoi Mocionin e Haradinajt si parashtrim të vlefshëm.⁶

5. Më 29 shtator 2021, si Mbrojtja e Gucatit ashtu dhe Mbrojtja e Haradinajt dorëzuan kërkesat për rishikimin e Urdhrit, ku kërkonin leje për dorëzimin e kundërpërgjigjeve ndaj Përgjigjes (“Kërkesat”).⁷

6. Më 30 shtator 2021, Trupi Gjykses udhëzoi të dy ekipet e Mbrojtjes të dorëzonin kundërpërgjigjet ndaj Përgjigjes brenda datës 4 tetor 2021.⁸

7. Më 4 tetor 2021, Mbrojtja e Gucatit dhe Mbrojtja e Haradinajt dorëzuan kundërpërgjigjet ndaj Përgjigjes (“Kundërpërgjigjet”).⁹

8. Më 7 tetor 2021, me fillimin e paraqitjes së provave, Trupi Gjykses nxori urdhër gojor me anë të së cilit bëri me dije se Kërkesat ishin rrëzuar dhe se shumë shpejt do të lëshonte urdhrin me shkrim.¹⁰ Trupi Gjykses paraqet më poshtë arsyet për vendimin.

II. PARASHTRIME

9. Në mocionin e vet për rishikim, Mbrojtja e Gucatit parashtron se, duke nxjerrë Urdhrin para datës kur të akuzuarit kishin të drejtë të kundërpërgjigjeshin në përputhje me rregullat 9(2) dhe 76 të Rregullores, Trupi Gjykses ka gabuar qartë në arsyetim.¹¹ Mbrojtja e Gucatit më tej argumenton se Urdhri ishte i parakohshëm dhe

⁶ Urdhri, 27 shtator 2021, para. 9.

⁷ F00335, Mbrojtja e Gucatit, *Kërkesë për Rishikimin e Vendimit F00328* (“Kërkesa e Gucatit”), 29 shtator 2021; F00338, Mbrojtja e Haradinajt, *Kërkesë për Rishikimin e Vendimit F00328 mbi Mocionet e Mbrojtjes sipas Rregullës 117* (“Kërkesa e Haradinajt”), 29 shtator 2021.

⁸ F00344, Trupi Gjykses, *Urdhër drejtuar për Mbrojtjen të për Dorëzohë Kundërpërgjigje për F00322* (“Urdhri për Dorëzimin e Kundërpërgjigjeve”), 30 shtator 2021.

⁹ F00349, Mbrojtja e Gucatit, *Kundërpërgjigje ndaj Përgjigjes Përmbledhëse të Prokurorisë lidhur me Kundërshtimin e Mbrojtjes për Pranueshmërinë* (“Kundërpërgjigjja e Gucatit”), 4 tetor 2021; F00348, Mbrojtja e Haradinajt, *Kundërpërgjigje e Mbrojtjes ndaj KSC-BC-2020-007/F00322*, (“Kundërpërgjigjja e Haradinajt”), 4 tetor 2021.

¹⁰ Urdhri Gojor mbi Mocionet sipas Rregullës 117(2), 7 tetor 2021 (transkript në kohë reale), f. 37, rreshtat 6-8.

¹¹ Kërkesa e Gucatit, para. 6-7, 9.

kufizonte në mënyrë të padrejtë të drejtat e të akuzuarit sipas rregullës 76 të Rregullores.¹² Mbrojtja e Gucatit kërkon prej Trupit Gjykses të rishikojë Urdhrin, duke mbajtur parasysh kundërpërgjigjen e Mbrojtjes.¹³

10. Mbrojtja e Haradinajt paraqet argumente të ngjashme në mocionin e vet për rishikim dhe kërkon të njëjtin mjet juridik sikurse Mbrojtja e Gucatit.¹⁴ Gjithashtu, Mbrojtja e Haradinajt jep shpjegim për vonesën në dorëzimin e Mocionit të Haradinajt dhe pretendon se kritikrat e Trupit Gjykses në lidhje me këtë janë krejtësisht të paarsyetuara dhe të papërligjura.¹⁵

11. Në kundërpërgjigjen e vet, Mbrojtja e Gucatit argumenton se kundërshtimi i pranueshmërisë së dëshmimeve të pritshme të W04842-shit dhe W04841-shit nuk është i parakohshëm,¹⁶ dhe se përcaktimi i themelësisë së Mocioneve përpara fillimit të gjykimit do të shërbente për të njoftuar palët lidhur me qëndrimin e Trupit Gjykses dhe për rrjedhojë do të garantonte kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit.¹⁷ Mbrojtja e Gucatit pranon se Trupi Gjykses mund të shtyjë vendimin lidhur me Mocionin e Gucatit,¹⁸ dhe argumenton se pikërisht kjo do të parapëlqejë më shumë se sa rrëzimi i mocionit me arsyetimin se është i parakohshëm.¹⁹ Mbrojtja e Gucatit parashton se deklaratat e W04842-shit nuk përmbajnë informacione lidhur me aspektet për të cilat ZPS-ja pretendon se ai është në gjendje të dëshmojë.²⁰ Në lidhje me W04841-shin, Mbrojtja e Gucatit argumenton se dëshmia e saj e pritshme lidhur me pjesët e panxjerra të paketave është tepër paragjyquese dhe zhbën çdo vlerë

¹² Kërkesa e Gucatit, para. 8.

¹³ Kërkesa e Gucatit, para. 2, 11.

¹⁴ Kërkesa e Haradinajt, para. 2, 5, 6(b), 21-32.

¹⁵ Kërkesa e Haradinajt, para. 6(a), 7-20.

¹⁶ Kundërpërgjigjja e Gucatit, para. 6-8.

¹⁷ Kundërpërgjigjja e Gucatit, para. 14-21.

¹⁸ Kundërpërgjigjja e Gucatit, para. 13.

¹⁹ Kundërpërgjigjja e Gucatit, para. 22.

²⁰ Kundërpërgjigjja e Gucatit, para. 28.

provuese aq shumë saqë nuk mund të verifikohet gjatë marrjes në pyetje nga Mbrojtja.²¹

12. Në kundërpërgjigjen e vet, Mbrojtja e Haradinajt parashtron se provat e kundërshtuara nuk duhet të pranohen për shkak të vlerës së kufizuar provuese, por edhe sikur të konsideroheshin prova, janë aq paragjykuese saqë zhbëjnë çdo vlerë provuese.²² Mbrojtja e Haradinajt argumenton se, nëse është dëgjuar dëshmi e cila përndryshe kishte qenë e papranueshme, atëherë kjo dëshmi do të ishte paragjykuese për shkak se tashmë ishte shqyrtuar.²³ Mbrojtja e Haradinajt më tej pretendon se argumentet e ZPS-së dhe hapat e mëtejshëm që propozon janë në mospërputhje me ato që bën lidhur me dëshmitarët dhe provat e Mbrojtjes, dhe se duhet të ketë barazi në qasjen e vet.²⁴ Mbrojtja e Haradinajt argumenton se W04842 nuk është në gjendje të dëshmojë lidhur me dëshmitarët që sugjerojnë se janë ndikuar negativisht, dhe se nuk duhet lejuar të dëshmojë, sidomos kur dëshmitari që pretendohet se është prekur është i gatshëm të dëshmojë: W04842 lidhur me këto pika, do të jepte opinione e jo prova.²⁵

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

13. Në pajtim me rregullën 79 të Rregullores, me kërkesë të një pale, në rrethana të veçanta dhe kur është vërtetuar se një arsyetim është qartësisht i gabuar, apo kur rishikimi është i domosdoshëm për të shmangur padrejtësinë, një panel mund t'i rishikojë vendimet e veta.

14. Rishikimi është një masë e veçantë që duhet të ndërmerret vetëm në rast se vërtetohet arsyetim i gabuar ose nëse është i domosdoshëm për të shmangur

²¹ Kundërpërgjigjja e Gucatit, para. 39.

²² Kundërpërgjigjja e Haradinajt, para. 27-29.

²³ Kundërpërgjigjja e Haradinajt, para. 9.

²⁴ Kundërpërgjigjja e Haradinajt, para. 22-23.

²⁵ Kundërpërgjigjja e Haradinajt, para. 25.

padrejtësi. Fakte dhe argumente të reja që dalin pas nxjerrjes së Urdhrit të kontestuar mund të jenë të vlefshme për këtë vlerësim.²⁶

IV. DISKUTIM

15. Trupi Gjykses vëren se Kërkesat bazohen kryesisht në argumentin se Trupi Gjykses ka gabuar qartësisht në arsyetim duke nxjerrë Urdhrin përpara përfundimit të afatit për dorëzimin e kundërpërgjigjeve. Veç kësaj, Mbrojtja e Haradinajt pretendon se Trupi Gjykses ka gabuar në arsyetim duke konstatuar se Mocioni i Haradinajt është dorëzuar jashtë afatit.

16. Trupi Gjykses shqyrtoi me kujdes të gjitha parashtrimet, përfshirë Kundërpërgjigjet, dhe tanimë duhet të vendosë nëse të akuzuarit kanë vërtetuar arsyetim të gabuar në Urdhër, apo nëse është i domosdoshëm rishikimi i Urdhrit për të shmangur padrejtësinë.

A. DORËZIM I VONUAR I MOCIONIT TË HARADINAJT

17. Trupi Gjykses merr parasysh shpjegimet e dhëna prej Mbrojtjes së Haradinajt lidhur me rrethanat e dorëzimit të mocionit.²⁷ Trupi Gjykses vëren se, në kohën që doli Urdhri, nuk kishte asnjë tregues për Trupin Gjykses lidhur me këto vështirësi të pretenduara dhe se Mbrojtja e Haradinajt në mënyrë të përsëritur në të shkuarën nuk i ka respektuar afatet.²⁸ Sidoqoftë, Trupi Gjykses shprehimisht ka përcaktuar në Urdhër se “përkundër mosrespektimit të Rregullores prej Mbrojtjes së Haradinajt, në

²⁶ F00326, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Haradinajt për Leje për Apelimin e Vendimit për Materialin Filmik të Kontrollimit dhe Sekuestrimit*, 15 qershor 2021, para. 22.

²⁷ Kërkesa e Haradinajt, para. 10-20.

²⁸ F00136, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Mosnxjerrjen e Kontakteve të disa Dëshmitarëve*, 22 shkurt 2021, poshtëshënimi 10; F00178, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesat e Mbrojtjes për Leje për Apelim të Vendimit mbi Kërkesat për Informacion për Takimin Informues Diplomatik*, 9 prill 2021, para. 15; F00189, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Rishikimin e Paraburgimit të Nasim Haradinajt*, 23 prill 2021, para. 12; F00236, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Haradinajt për Leje për Apelimin e Vendimit për Materialin Filmik të Kontrollimit dhe Sekuestrimit*, 15 qershor 2021, para. 11; Transkript, Konferenca mbi Ecurinë e Çështjes, 14 korrik 2021, f. 360 rreshti 6 deri f. 362, rreshti 20.

përputhje me rregullën 9(5) të Rregullores dhe për të mbrojtur interesat e të akuzuarit, Trupi Gjykses, *proprio motu*, pranon Mocionin e Haradinajt si të vlefshëm.”²⁹ Trupi Gjykses mori parasysh në Urdhër të gjitha argumentet e paraqitura në Mocionin e Haradinajt dhe për rrjedhojë shpjegimet lidhur me vonesën e dorëzimit janë të tejkaluara.

18. Për këtë arsye Mbrojtja e Haradinajt nuk ka mundur të demonstrojë arsyetim të gabuar apo domosdoshmërinë e rishikimit për të shmangur padrejtësinë në lidhje me kritikën e Trupit Gjykses për dorëzimin e vonuar të mocionit.

B. DISKRECONI I TRUPIT GJYKSES PËR TË VENDOSUR LIDHUR ME MOCIONET PA MARRË KUNDËRPËRGJIGJET

19. Argumenti i përbashkët i Mbrojtjes se Trupi Gjykses gaboi në arsyetim duke nxjerrë Urdhrin pa pritur Kundërpërgjigjet është i tejkualuar, pasi Trupi Gjykses tanimë i ka shqyrtuar tërësisht Kundërpërgjigjet.

20. Për më tepër, ndonëse rregulla 76 e Rregullores u jep të drejtën palëve të dorëzojnë kundërpërgjigje pa kërkuar leje, kjo e drejtë nuk është absolute. Mbrojtja pranon se Trupi Gjykses mund të heqë ose të shkurtojë shprehimisht afatin për dorëzimin e kundërpërgjigjeve.³⁰ Gjithashtu, Trupi Gjykses ka diskrecion të vendosë lidhur me një çështje pa pritur kundërpërgjigjet, në qoftë se vendimi është në favor ose nuk i shkakton asnjë dëm palës prej të cilës pritet kundërpërgjigjja e së. Në Urdhër, Trupi Gjykses ka përcaktuar qartë se Mbrojtja do të ketë mundësinë: (i) të kundërshtojë pranueshmërinë e deklaratave përkatëse kur dëshmitarët të japin dëshmi gjatë gjykimit; (ii) të kërkojë që çdo vendim lidhur me pranueshmërinë e tyre të shtyhet derisa të përfundojnë pyetjet nga ana e Mbrojtjes dhe (iii) të pyesë dëshmitarët lidhur me aspektet e ngritura në Mocione.³¹ Trupi Gjykses ishte bindur kur u nxor Urdhri,

²⁹ Urdhri, para. 9.

³⁰ Kërkesa e Gucatit, para. 7; Kërkesa e Haradinajt, para. 26.

³¹ Urdhri, para. 12.

dhe mbetet i bindur se Mbrojtjes nuk i është shkaktuar asnjë dëm nga marrja e vendimit për çështjen përpara dorëzimit të kundërpërgjigjeve.

21. Për këto arsye, Trupi Gjykses konstaton se Mbrojtja nuk ka mundur të vërtetojë arsyetim të gabuar apo padrejtësi që buron prej nxjerrjes së Urdhrit të Trupit Gjykses përpara përfundimit të afateve për dorëzimin e kundërpërgjigjeve.

C. A PËRLIGJIN KUNDËRPËRGJIGJET NDRYSHIMIN APO PRAPËSIMIN E URDRIT

22. Siç u theksua, Trupi Gjykses i shqyrtoi Kundërpërgjigjet kur vendosi nëse duhej të rishikonte Urdhrin dhe bën konstatimet e mëposhtme.

23. Trupi Gjykses kujton se, Mbrojtja në Mocionet e veta nuk kundërshton që të thirren dëshmitarët për të dhënë dëshmi, e as nuk kundërshton rëndësinë e pjesës së dëshmimeve të tyre të propozuara.³² Palës i jepet diskrecion në njëfarë mase për të vendosur se cilat prova do të paraqesë për të mbështetur argumentet e veta. Sidoqoftë, ky diskrecion nuk është i pakufizuar. Trupi Gjykses vëren, në veçanti, se rregullat 118(1)(a) dhe 119(3)(a) të Rregullores i japin kompetencë trupit gjykses të përcaktojë numrin e dëshmitarëve që mund të thërrasin palët, dhe të udhëzojë palët të heqin dëshmitarët përsëritës. Rregulla 138(1)-(3) e Rregullores autorizon Trupin Gjykses të përjashtojë provat në rrethanat e përcaktuara në të. Këto rregulla, të marra së bashku, lejojnë Trupin Gjykses të vendosë të mos dëgjojë dëshmitarët, dëshmitë e të cilëve nuk është treguar se kanë lidhje me çështjen gjyqësore ose janë të përsëritura. Sidoqoftë, në këtë rast, Mocionet kundërshtojnë mundësinë që ZPS-ja të paraqesë dëshmitë e propozuara për t'u pranuar me arsyen se pjesë të tyre janë dëshmi të dorës së dytë të palejueshme, privojnë Mbrojtjen nga mundësia për ballafaqim efektiv ose kanë të bëjnë me materiale të panxjerra që nuk i janë vënë në dispozicion Mbrojtjes.³³ Ky nuk është mjet juridik i mbështetur në dispozitat e përmendura më lart apo në burime të tjera juridike përkatëse. Mbrojtja nuk paraqet asnjë bazë ligjore në mbështetje të

³² Urdhri, para. 11.

³³ Urdhri, para. 11.

pozicionit të vet se pranimi i dëshmime të propozuara duhet të trajtohet para se këto dëshmi të paraqiten efektivisht. Kundërpërgjigjet nuk sjellin asgjë të re në këto argumente.

24. Trupi Gjykses përsërit konstatimet e veta të mëparshme se dëshmitë e kontestuara nuk janë paraqitur ende për pranim dhe se Mbrojtja do të ketë mundësi të drejtë dhe të plotë të kundërshtojë pranimin e tyre kur të paraqiten. Gjithashtu, Mbrojtja do të ketë mundësi të shumta t'u drejtojë pyetje dy dëshmitarëve lidhur me pikat që paraqiten në Mocione. Si rezultat, shtyrja e vendimit lidhur me pranimin e dëshmime deri në momentin që do të paraqiten, nuk i shkakton asnjë dëm Mbrojtjes.

25. Trupi Gjykses rrëzon argumentin se dëgjimi i një dëshmie që mund të konsiderohet më vonë e papranueshme, i shkakton dëm Mbrojtjes.³⁴ Përkundrazi, fakti se Trupi Gjykses dëgjon dëshmi nuk cenon vendimin e tij lidhur me vlerën provuese të këtyre dëshmime, dhe nuk pengon Trupin Gjykses që më pas t'i përjashtojë dëshmitë në fjalë në përputhje me rregullën 138 të Rregullores.

D. PËRFUNDIM

26. Në lidhje me sa më sipër, Mbrojtja nuk ka mundur të demonstrojë arsytim të gabuar apo që rishikimi i Urdhrit është i nevojshëm për të shmangur padrejtësinë.

V. VENDIM

27. Për këto arsye, Trupi Gjykses:

- a. **RRËZON** Kërkesat; dhe
- b. **KUJTON** Mbrojtjen e Haradinajt lidhur me urdhrin e vet për dorëzimin e versionit të redaktuar publik të Mocionit të vet (F00318) brenda **11 tetorit 2021**.

³⁴ Kundërpërgjigjja e Haradinajt, para. 9.

/nëshkrimi/

Gjykatësi Çarls L. Smith, III

Kryegjykatës

E enjte, 7 tetor 2021

Në Hagë, Holandë